

OPINION: NGA MARGJINAT E NJË TAKIMI

Kisha në Universitet apo Universiteti në kishë

Të martën, më 09.02.2016, u mbajt një takim i rregullt i Institutit D4D. Si zakonisht, por tema ishte shumë më intriguese: Çfarë të bëjmë me kishën e papërfunduar në qendër të Prishtinës?. “Ura” mes komunitetit shqiptar (shumicë) dhe atij serb (joshumicë).

Ura si urë, nga një këndvështrim - lidh dy brigje, por nga tjetri, ndan të njëjtat...

Nëse kalohet është e para, në të kundërtën është ajo e dyta.

Nuk është fjala për Mitrovicën. “Ura” - temë, ishte Kisha Ortodokse e Krishtit Shpëtimtar, në mes të Prishtinës. Në Kampusin Universitar, unik, ndoshta edhe në botë, për nga pozicioni, kompaktësia dhe strukturimi. Mu në mes, të Qytetit (Universitar).

Kosova, e në veçanti, Prishtina, karakterizohet, por edhe mburret, me rininë studentore. Universiteti i Prishtinës, natyrisht, si lider, prin me këta numra!

Kosova e re, shtet laik, edhe ajo e vjetra, bashkë me Shqipërinë, së bashku, mburren me tolerancën ndërfaqetare.

Shqiptarët e këtyre trevave, ndër-tuan manastiret më të vjetra ortodokse, i mbrojtën ato me devotshmëri gjatë shekujve. Kurrë nuk i përdhosën. As kishat as xhamitë. Strehuan hebrejtë. Por, po ndodh e kundërta. Kisha Ortodokse Serbe përdhosi Universitetin. Dhe vazhdon me përdhosje!

Kisha filloi së ndërtuari në vitet e egërsisë së okupimit serb të

në Universitet.

Të paktë ishin përfaqësuesit e palëve të involvuara, përjashtuar ekipit të Komunës së Prishtinës, që ishin në numër (Sh. Ahmeti, D. Sejdiu...), askush nga Qeveria, as ministri i Planifikimit Hapësinor, as ndokush nga ministratë tjera. Nuk kishte përfaqësues të partive politike. Vetëm lëvizja “Vetëvendosje”.

Diskutimin e filloi z. Shpend Ahmeti, i cili në cilësinë e kryetarit të Komunës i elaboroi aspektet e trajtimit të objektit në fjalë. Me një elaborim konciz, përfshiu katër fusha: atë ligjore, të lirive të shprehjes - fetare, aspektin politik dhe atë urbanistik. Fuqia e kryetarit ndalet në vendimin gjyqësor, sipas procesit që është në vijim. Mbetet të pritet vendimi i gjyqit.

M'u kujtua drama e E. Kryeziut, “Epoka para gjyqit”, një shfaqje teatrore, nga e cila shkëputa: titullin dhe skenën, dhe Ligjet e Perëndisë! Vallë, a 17 vjet pas okupimit, ende luajmë në skenë? Shpendi si Abdyl, e Dardani si Sylejman Vokshi... Apo një gjyq do të saktëjë të ardhmen e hapësirës universitare, në bazë të letrave dhe fakteve të parafabrikuara??!

Kryetari duhet të mbrojë interesat e qytetarëve të tij. Gjyqi ka punën e vet. Por interesi publik, mbi të gjitha! Pa mëshirë ndaj “veprimeve milosheviqiane”. Të Kishës Ortodokse Serbe.

Milosheviqi, një kriminel, i vdekur i padënuar, një kasap i cili solli tmerr në Ballkan, e kishte

mbi varrin e pashënuar të kasapit, në Pozharevc të Serbisë?

Apo ta shënojmë dhe ta gdhendim, mbi të, një shenjë të shprehjes së vullnetit të mirë? Se nuk na shfarosi të gjithëve. Që të marrim poenë! Në lojën pa sete, dhe në lojën pa fund! Në Bruksel.

Ishte nënkryetari Dardan Sejdiu që u ngit kundër qëndrimeve të pakuptimit të ambasadorit. Ishin pjesëmarrës tjerë që sugjeruan njohjen e Republikës në vend të uzurpimit të pronës. Ishte autori i këtyre rreshtave që shpjegoi se nuk bëhet fjalë “për legalizim të objektit të kishës”, por gjeneza e problemit është më e thellë. Nuk bëhet fjalë për të ashtuquajturën “Kisha e Shpëtimtarit të Shenjtë”. Jo. Flitet për ndarjen e Kampusit në dysh. Për Tempullin e Krishtit Shpëtimtar, pandan i po të njëjtit “tempull” në Moskë. Për një kompleks ndërtimi, shumë hektarësh, në zemrën e Universitetit. Me këtë përbërje: objekti i kishës, objekti i institutit të kulturës shpirtërore dhe historisë kishitare, flitet për kioskën - shitoren e vendosur në cep të ndërtesës së tashme të Rektoratit, të kooperativës së kishës, flitet për tualete nëntokësore, për besimtarët, në mes të kompleksit, për dyqanet e luleve e për shumë të tjera. Të gjithë të Kishës Ortodokse Serbe! Apo të “urës bashkëpunuese” mes komuniteteve.

Përndryshe, dokumenti i cili nuk po ekzistua në arkivat e Ko-

një përkujtues i kohës së shtypjes, gjenocidit e urbicidit? Prapë: jo se jo.

A mos vallë duhet të ndjekë shembullin e Stambollit, dhe si Aghia Sophia, në atë kohë, Kisha të shndërrohet në Xhami, në Prishtinë, Jo, jo dhe jo. As popullata shumicë e besimit islam nuk do ta pranonte këtë. Pse? Lokacioni në mes të mesit të Kampusit, të një Qyteti Universitar, i cili nuk duron një gjë të tillë!

Shtuar kësaj se po na ekzistua edhe “Instituti i Kulturës Shpirtërore...” e thashë e më tha.

Vetë ati Sava Janjiq, në intervistë për Radio Europa e Lirë arsyeton ndërtimin, asokohe, të kishës, me faktin se numri besimtarëve ka qenë shumë i madh (gjithnjë sipas tij, mbi 40.000), dhe se kjo ka qenë arsyeja e ndërtimit. Po sot, ai numër sa është?

Numri i përgjithshëm i serbëve në Prishtinë kurrë nuk ka mund të arrijë shifrën e pretenduar, dhe në fund të fundit, kisha e tanishme, ajo e Shën Nikollës, në Taslixhe, është në vetëm 500 metra largësi nga ky lokacion. E mjaftueshme për të shërbyer për tërë komunitetin besimtar serb. Sot për sot. Besa edhe për miqtë e mi nga Shqipëria, kur gjatë fundjave vijnë në vizitë. Nëse ati i pranon.

Po të flisnim për lojëra të fatit, Ligji qartë e definon largësinë minimale nga objektet shkollore. Edhe pompat e benzinës... edhe ndotësit... vetëm kisha po bëka,

edhe nëse Brukseli, ambasadori, UNESCO apo ku ta di unë se kush, do të ndikonte të legalizohej si ndërtesë, ne, dhe vetëm ne, jemi ata që do të duhej mos të lejonim veprimtarinë e tij fetare a shpirtërore, në një Kampus Universitar. Posaçërisht jo në tonin. Përkundër shuplakës.

Ambasadorit Moschopoulos duhet t'i themi: pranoje realitetin, pranoje Republikën! Lëre kishën për besimtarët. Në vendin e tyre. Jashtë Universitetit. Kryetarit Ahmeti, i cili me gjenerozitetin e tij, ofroi truallin për ndërtim: Jepe truallin, e ke votën tonë, por me parimet harwardiane, me proporcionalitet dhe me reciprocitet.

Nënkryetarit agjil të Komunës, z. Sejdiu, t'i themi: Qëndro dhe shiko para. Pas na ke ne! D4D: vetëm vazhdoni.

Pjesëtarëve të komunitetit joshumicë, serb, z. Igorit, i cili elaboroi mirë çështjen, por gjithnjë bazuar në të vërtetën tij, z. Stojanoviq, zëvendëskryeministër, të cilit i kishte dalë “punë” për të bërë, mu në kohën e mbajtjes së Sallonit, e posaçërisht igumenit Sava Janjiq, i cili po ashtu nuk qe prezent:

pranoni dorën e pajtimit të pakushtëzuar, erdha pa kërkuar faljen e domosdoshme në këtë proces historik të pajtimit të popujve, dorën e cila mban faqen e skuqur ende, nga shuplaka(t) milosheviqiane, dhe pranoje dhuratën nga

jen e kryqit të pruar mbi të, në flakët e luftës së UÇK-së, në kohën e realizimit të planeve djallëzore të vrasjes, dhunimit dhe dëbimit të shqiptarëve, si thoshin: “përtej Bjeshkëve të Nemuna”. Kryqi i parë “i bekuar” nga mitropolit i atëhershëm Amfilohije, më 6.12.1992, nuk dukej më. Mbase ishte i drurit, dhe duhej zëvendësuar me një “më të mirë”.

Silueta e objektit të papërfunduar qëndron sot, si shtëpi e mallkuar, në zemër të Universitetit. Edhe Perëndia duket se ishte kundër. Përdhosjes. Ndarjes së Kampusit, tërësisë së Universitetit, unik si tërësi, sa territoriale, por edhe më shumë si funksionale, tani të ndarë, në tentativë, në dysh. Mu në mes!

Sallonistët ishin thirrur si çdo të martë. Si çdo të martë, u takuam. Por, këtë herë, për ndryshim, nuk pati mjaft vend për të gjithë të interesuarit.

Ishin të gjithë të interesuar, komuniteti i arkitektëve si kurrë më parë mbuloi numrat e analistëve, analistët numrat e komentuesve dhe publiku pjesëmarrës të gjithë këta numra. Dikush ulur, dikush në këmbë, e dikush nga jashtë, përcillnin me interesim se çka do të ndodhë me “Urën”.

Pas hapjes së zakonshme nga Leon Malazogu, moderimi vazhdoi nga Baton Haxhiu, me gjasë, këtë herë. Ishte ndryshe. “Ura” që shkak dhe shkas. Publiku po ashtu. Duhej përforsim.

“Urë” ishte i ashtuquajtur “legalizim” i shuplakës së pushtetit të Milosheviqit, në kuptim të ndërtimit të Kishës ortodokse në zemrën e Kampusit Universitar.

Por, pse “Kishë-Ura”... Mediat, pjesa e opinionit publik, posaçërisht përfaqësuesit e ambasadeve, e vlerësuan si të tillë. “Urë bashkimi, a “urë” ndarje, mes komuniteteve. Koncesion i radhës i shqiptarëve!

Një “urë” bashkimi, artificiale, dhe një vlerësim artificial i ndarjes. Një shuplakë e pranuar në vitet e okupimit, e cila kërkohet të merrret si përkëdhelje në vitet e lirisë. Një objekt demonizues që duhet të kuptoimë si engjëllor. “Dhuratë”

turimit, dëbimit, vrasjes dhe gjeno-cidit.

Dhe pse na doli tash Satana nga varri? Në vend se të prehet me mëkatet e veta, në varrin e pashënuar në Pozharevcin e tij, na doli këtu, mu në mes të Prishtinës, 17 vjet pas krimit, në formë të një letre të lexuar nga përfaqësuesja e ambasadorit grek, Dimitris Moschopoulos, zonja Johanna Hanson, ku konstatohej gjendja: se prona na qenka e Kishës Ortodokse Serbe, se objekti qenka ndërtuar në rregull dhe nuk bëka t'i ndërrohet destinimi dhe se po ekzistua njëfarë vendimi që, për hir të ‘imazherisë’ së Kosovës (term i huazuar nga vokabulari i kryetarit Ahmeti) po u dashka këtë ‘urë’ ta përqafojmë, dhe me këtë t’i japim legjitimitet ndërtimit (kupto: aparteidit urbicidal milosheviqian) për të “fituar poenë politike në Bruksel” (kjo e fundit - kuptuar nga autori i tekstit). Deri kur më me poenë, u grumbulluan shumë ende pa fituar as edhe një set, në këtë “lojë”.

Zonja Hannson nuk pranoi të marrë pjesë në debat, por me përpikëri shënonte vërejtjet për t’ia përcjellë ambasadorit. Por, ai që kërkon “urë” e nuk kalon nëpër të, çka kërkon?

Na qenka njëfarë investimi i përbashkët i qeverive kosovare dhe serbe, lidhur me këtë. Ndoshta edhe greke, apo ishte vetëm nisma e tyre. Nuk u kuptua qartë.

Por, u kuptua se “ata” kishin konstatuar se pronësia është e Kishës Ortodokse Serbe. Lejen, se është lëshuar në mënyrë të rregullt, dhe me kohë, si dhe ndërtimin, i cili duhet të vazhdonte. Mu në mes. Të Universitetit. Ta ndajë në dysh, “urë” bashkimi, tolerance, mirëkuptimi dhe çka jo tjetër. Të rrënojë brigjet ku mbështetet “ura”.

Por, pse ne të jemi ndërtuesit (e ‘urave’), për shkatërruesit e brigjeve?

A duhet ‘ura’ jonë të rehabilitojë bëmat milosheviqiane? A nuk ishte dënim i mjaftueshëm, për ne, vdekja pa gjykim e kasapit Milosheviq? Tash të bëimë ‘urën’ e të

15.02.1999, lëshuar për Kishën Ortodokse Serbe, për ndërtim në pjesën e parcelës Nr.7090/14!!!

Z. ambasador, këshilltar në institucionet qeveritare për trashëgimi kulturore dhe fetare, ju përkujtoj se “leja” është retroaktive, dhe e paantidatue, e lëshuar në kohën e okupimit total të Kosovës, dhe flet për pjesën e parcelës të ndarë në mënyrë arbitrare nga okupuesit e atëhershëm.

Flitet për mbi 4 hektarë tokë! Nëse matet largësia nga rrua interne pranë Fakultetit Juridik dhe Ekonomik gjatësia është 185 metra deri te cepi i Bibliotekës, ndërsa në drejtimin tjetër nga Rektorati deri në rrugën “Agim Ramadan”, janë 230 metra të tjera. Gjithsej mbi 40.000 m². A janë këto 4 hektarët e “ndarë” për kishën. Atëherë, a po flasim për një sipërfaqe sa 8 fusha të futbollit ngjitur!!!!

A është kjo “prona” e kishës sipas z. ambasador? E gjithë hapësira e lirë. Gati 1/2 e Kampusit. A janë këto shifra?

Po edhe të bëhej, a thua miqtë e mi, të besimit ortodoks, nga Shqipëria e Jugut, mund të shfrytëzonin këto hapësira? Janë ortodoksë, por s’janë serbë!

Po edhe të bëhej, fëmijët e mi a mund t’i shfrytëzonin këto hapësira? S’janë as ortodoksë e as serbë!

Ati Sava Janjiq, igumen i KOS-it, shumë herë në rrjetet sociale i vërsulet kryetarit Ahmeti. Për ‘legalizimin’ e objektit, për të cilin pretendon se është legal. Kurrë nuk provoi se ka edhe dokumente milosheviqiane për këtë.

Neglizhoi të gjitha institucionet se gjoja se “nuk ka ditur se kujt t’i drejtohet”. Por, edhe po të ishin dokumentet milosheviqiane, po të ishte objekti ‘legal’, a do të ishte legjitime Kisha ortodokse serbe të ushtrojë veprimtarinë e saj në këtë vend. Jo. Apo po aq sa edhe në Aghia Sophia në Stamboll! Edhe aty Kisha ortodokse pretendon menaxhimin, por jo, ajo që është shndërruar në Xhami dikur, sot është muze i kohës. Po, a duhet grumbulli i tullave në mes të Kampusit Univer-

itetit të shqiptarëve të shqiptarëve të bekuar e të vendosur mbi objektin e pretenduar për faltore, të cilin ju premtoj se me kujdesin më të madh do ta demontojmë dhe me kujdes edhe më të shtuar do t’ju sjellim në lokacionin e dëshiruar, dhe mos manipuloni me fakte të paqena.

Jashtë Universitetit. Lërin fëmijët tanë rehat.

Po çka pastaj? Çka të bëhet me objektin e mbetur? Pos kompensimit të materialit të harxhuar, për ndërtuesin, parcelës dhe relikteve kthyesë, objekti të rifunksionalizohet për përdorim akademik, për nevoja të Universitetit, apo si u tha nga sallonistët, profesoreshat e nderuara znj. Besa Luzha dhe znj. Lejla Pula, në mungesë të sallës së Fakultetit të Arteve, të jetë e shndërruar një të tillë. A t’ju uroj tash?

Profesori i urbanistikës, dr. Ilir Gjinolli, e shpjegoi shkëlqyeshëm çështjen legale, dhe e argumentoi se për të ekzistuar një veprim i tillë do të duhej naprakisht të ndryshohej Plani urbanistik i Komplexit Universitar, e që me shembuj e konkretizoi.

Por, shtrohet pyetja: a duhet të legalizohet edhe shuplaka milosheviqiane që të gjithë ne, të skuqurën ende e mbajmë të fshehur në faqet tona? Apo duhet për shkak të “imazherisë” ta tejkalojmë edhe këtë sfidë? Të lëmë studentët të mësojnë nën tingujt e kishës e të kabanave, murgjit të na shesin lule e literaturë kishtarë në oborret e fakulteteve, ndërsa zhvillohen studimet e njëkohësisht ktitorët e ndryshëm japin mësim në institutin kishtar, derë më derë me Fakultetin e Arteve të Bukura, derë më derë me Fakultetin e Edukimit, duke mbështetur dorën në faqen e flakëshur, me shuplakë milosheviqiane, e tash me shuplakën e radhës, atë të ‘imazherisë’ – atë të Brukselit.

Apo ndoshta, si tha kryetari Ahmeti, të presim vendimin e Gjyqit? Para apo pas Brukselit? Të ndikuar, apo autonom? Me apo pa shuplakë. Na ka mbetur edhe një anë e fytyrës. Edhe një faqe. A ta harxhojmë për shuplakën e radhës.

Pajtohemi, në një send: për shkak të ‘imazherisë’ objekti do të duhej të mbetej. I parrënuar. Si i tillë do të duhej t’i shërbente vetëm, dhe vetëm Universitetit. Se a do të kompensohet, apo sa do të kompensohet ndërtuesi ilegal, është çështje

besimtarët taaj, pranoje kryqit e bekuar e të vendosur mbi objektin e pretenduar për faltore, të cilin ju premtoj se me kujdesin më të madh do ta demontojmë dhe me kujdes edhe më të shtuar do t’ju sjellim në lokacionin e dëshiruar, dhe mos manipuloni me fakte të paqena.

Jashtë Universitetit. Lërin fëmijët tanë rehat.

Po çka pastaj? Çka të bëhet me objektin e mbetur? Pos kompensimit të materialit të harxhuar, për ndërtuesin, parcelës dhe relikteve kthyesë, objekti të rifunksionalizohet për përdorim akademik, për nevoja të Universitetit, apo si u tha nga sallonistët, profesoreshat e nderuara znj. Besa Luzha dhe znj. Lejla Pula, në mungesë të sallës së Fakultetit të Arteve, të jetë e shndërruar një të tillë. A t’ju uroj tash?

Po objekti si i tillë, çka paraqet? Për gjeneratat e tashme, përpos shuplakës së përjetuar, edhe një ‘relikt’ milosheviqian, një prove e urbididit të kryer, të një përgatitje për gjenocidin pasues, një kujtesë të hidhur dhe të ngulitur.

Çka duhet të paraqiste? Historinë e tejkaluar, një rimodelim arkitektural, e strukturor, të cilin pjesëmarrësit e heshtur të sallonit, arkitektët në numër e me famë, do të duhet t’u përcillnin bashkëpunëtorëve, gjegjësisht studentëve, si detyrë projektuese, që pas një studimi meritor të dalin me propozimet e tyre për një dukje të re, të përshtatur vendit dhe kohës, të transformuar në frymën e trendëve bashkëkohorë. Të mos lejojmë ndotjen e kujtesës kolektive të gjeneratave që vijnë

së paku me shprehjen arkitekturore dhe me funksion përmabajtesor. Ndotja e kujtesës kërkon trajtim sociologjik, psikologjik, dhe në fund edhe psikiatrik. Diskutuam për kishën pretenduar ortodokse, por menduam në fëmijët tanë, në atë se çka do t’u lëmë traslëgimi.